



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo*

# **PREZANTIMI I AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS**

**Material hyrës**  
**Informacione Bazike për Statisticientët e rinj**

Prishtinë, 2020

## Lista e përmbajtjeve

<b>3. Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>4. Roli dhe detyrat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës</b> .....	<b>3</b>
4.2. Misioni dhe objektivi i ASK-së .....	3
4.3. Detyrat kryesore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.....	4
4.4. Të dhënat statistikore të prodhuara nga ASK.....	5
4.5. Metodologjia.....	7
4.6. Shpërndarja / diseminimi i statistikave zyrtare .....	8
4.7. Monitorimi dhe raportimi.....	9
<b>5. Struktura organizative e ASK-së</b> .....	<b>9</b>
5.3. Statistikat Ekonomike .....	10
<b>6. Dokumentet relevante</b> .....	<b>11</b>
<b>7. Shtojca nr 1. Grafiku i organizimit të ASK-së</b> .....	<b>12</b>

### 3. Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është themeluar në vitin 1999 si institucion i pavarur nën Ministrinë e Administratës Publike. Pas miratimit të Ligjit për Statistikat Zyrtare në vitin 2011, deri në Korrik 2020, ASK ka funksionuar nën Zyrën e Kryeministrit, si institucion i pavarur profesional, përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare dhe çështje të tjera që lidhen me statistikën të përfshira në Programin e Statistikave Zyrtare. Me vendimin e Qeverisë, nr 03/209, date 01/07/2020, ASK, nga Zyra e Kryeministrit bartet në Ministrinë Financave. ASK është bartësi, shpërndarësi dhe bashkërenduesi i sistemit statistikor të Kosovës. Ligji për Statistikat Zyrtare (nr. 04/L-036) rregullon statistikën zyrtare të Kosovës, Sistemin Kombëtar të Statistikave (SKS) dhe rolin dhe përgjegjësitë e ASK-së. Në këtë kuadër, ASK ka rolin kryesor koordinues në prodhimin e statistikave zyrtare në Kosovë.

Financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe donatorët, sipas legjislacionit në fuqi, ASK është organizatë autonome buxhetore me kodin e vet buxhetor. ASK gjithashtu krijon të ardhura vetanake nga shërbimet të parapara me Ligjin për Statistikat Zyrtare.

### 4. Roli dhe detyrat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

#### 4.2. Misioni dhe objektivi i ASK-së

Vetë ekzistenca institucionale e Agjencisë së Statistikave të Kosovës është e lidhur në mënyrë të qartë me prodhimin statistikor në mënyrë që të plotësojë nevojat e përdoruesve me të dhëna zyrtare statistikore. Qëllimi i prodhimit të të dhënave statistikore është të plotësojë nevojat e përdoruesve privatë dhe publik me të dhëna statistikore sipas standardeve të Eurostat-it, si në prodhimin e të dhënave statistikore ashtu edhe në cilësinë e të dhënave statistikore.

Në këtë kuadër, misioni i ASK është të **sigurojë ofrimin e statistikave zyrtare me cilësi të mirë, në kohë dhe në mënyrë përkatëse në mënyrë që plotësojnë nevojat e të gjithë përdoruesve** në sektorin publik dhe privat të Kosovës si dhe nevojat e institucioneve tjera bashkëpunuese ndërkombëtare.

**Objektivi** i ASK është **të prodhojë dhe publikojë statistika zyrtare që plotësojnë nevojat e Kosovës** qoftë drejtpërdrejt, qoftë përmes aktiviteteve të veta për mbledhjen e të dhënave, ose indirekt, duke koordinuar, harmonizuar dhe siguruar që informacioni statistikor cilësor që prodhohet nga institucione të tjera të bazuara në Legjislacionin në fuqi.

Sipas **Ligjit për Statistikat Zyrtare në Kosovë**, ASK-ja duhet të zhvillojë statistika sipas standardeve të Eurostat-it. Në këtë kuadër, ASK ka bashkëpunuar ngushtë dhe vazhdon të bashkëpunojë me partnerë ndërkombëtarë në mënyrë që të rritet cilësia e statistikave zyrtare në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e statistikave zyrtare.

### 4.3. Detyrat kryesore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës

ASK, si prodhuesi kryesor dhe shpërndarës i të dhënave statistikore në Kosovë, ka një seri detyrash që lidhen me prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, por edhe atë të planifikimit dhe koordinimit të Sistemit të Statistikave në Kosovë. Detyrat kryesore të ASK-së, të përcaktuara në **Ligjin nr. 04/L-036 mbi Statistikat Zyrtare**, mund të grupohen në disa kategori bazuar në natyrën e tyre:

#### a.) Detyrat e planifikimit:

- të përgatisë draftin e Programit të Statistikave Zyrtare dhe Planet Vjetore të Statistikave Zyrtare në konsultime me Këshillin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- të përgatisë dhe organizojë zbatimin e aktiviteteve zyrtare të lidhura me statistikatat të përcaktuara nga Programi;

#### b.) Detyrat në lidhje me zhvillimin e metodologjisë statistikore:

- të përcaktojë dhe zhvillojë metodologjinë statistikore, klasifikimin dhe standardet për prodhimin e Statistikave Zyrtare;
- të kryejë studime dhe hulumtime mbi metodologjinë statistikore dhe të zhvillojë më tej metodologjinë dhe teknologjinë statistikore;

#### c.) Detyrat e prodhimit dhe shpërndarjes:

- të mbledhë të dhënat e nevojshme statistikore, të analizojë, publikojë dhe shpërndajë rezultatet statistikore;
- të rrisë kapacitetet statistikore dhe njohuritë e punonjësve që punojnë në fushën e statistikave zyrtare;
- të ofrojë ndihmë profesionale dhe shpjegim teknik të rezultateve për të shmangur interpretimin e gabuar të të dhënave të ofruara në Statistikat Zyrtare;

#### d.) Detyrat e analizës dhe monitorimit:

- të monitorojë kryerjen e detyrave statistikore të imponuara për autoritetet e tjera nga programi statistikor;
- përmes Ministrit të Ministrisë Kompetente, t'ia paraqesë për miratim Qeverisë dhe Kuvendit, raportin për zbatimin e planit, programit dhe përdorimit të fondeve buxhetore dhe më pas të publikojë Raportin Vjetor të miratuar;

#### e.) Detyrat e bashkëpunimit:

- të promovojë njohuri mbi statistikatat në bashkëpunim me universitetet;
- të bashkëpunojë me organizatat vendore dhe ndërkombëtare që janë kompetente për statistikatat zyrtare në mënyrë që të mundësojnë krahasimin e statistikave zyrtare me statistikatat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore.

#### 4.4. Të dhënat statistikore të prodhuara nga ASK

ASK është institucioni kryesor i Sistemit Statistikor të Kosovës në prodhimin e të dhënave zyrtare statistikore. Përdorues kryesor të të dhënave statistikore janë ministritë e linjës, qeveria dhe institucione të ndryshme tjera publike dhe private, bizneset dhe publiku i gjerë, të cilat shërbehen me të dhëna statistikore zyrtare për procese të ndryshme të vendimmarrjes. Për më tepër, ASK gjithashtu ka qasje në statistikat evropiane dhe statistikat e tjera zyrtare ndërkombëtare.

Duhet të përmendim që ASK nuk është prodhuesi i vetëm i të dhënave statistikore në Kosovë. Ofruesit e tjerë specifik të statistikave zyrtare janë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave dhe institucionet e tjera të autorizuara nga ASK, të përcaktuara me ligj.

Të gjitha të dhënat statistikore të publikuara nga ASK konsiderohen statistika zyrtare, pavarësisht nga metoda e shpërndarjes (botime të shtypura, internet, media elektronike, redaktim i personalizuar).

Elementet kryesore të prodhimit statistikor të ASK-së:

##### 1. **Publikuar në baza vjetore:**

- BPV me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve,
- Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve,
- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHCK-HICP),
- Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Kosovës,
- Llogaritë Qeveritare,
- Anketa PRODCOM,
- Bilanci i Energjisë,
- Anketa e Ekonomive Bujqësore,
- Llogaritë Ekonomike për Bujqësinë,
- Indeksi i Çmimeve në Bujqësi,
- Mbeturinat Industriale,
- Mbeturinat Komunale,
- Trajtimi i Mbeturinave,
- Statistikat e ajrit (GHGE),
- Anketa e Fuqisë Punëtore,
- Niveli i Pagave në Kosovë,
- Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit,
- Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC),
- Anketa e bugjetit të Ekonomive familjare ( me frekunce njëherë në 3-4 vjet)
- Të dhëna shëndetësore,
- Të dhëna për arsimin,
- Të dhëna të mirëqenies sociale,
- Statistikat e krimit,
- Statistikat e kulturës,
- Lindjet, Vdekjet, Shkaqet e Vdekjes, Martesat, Shkurorëzimet, Statistikat Gjinore,

- Vlerësimi i popullsisë,
- Vjetari Statistikor,
- Kalendari i Publikimeve,
- Katalogu i Publikimeve.

## **2. Publikuar në baza tremujores:**

- BPV me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve,
- Llogaritë Qeveritare,
- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit,
- Indeksi i Çmimeve të Importit,
- Indeksi i Kostos së Ndërtimit,
- Bilanci i Energjisë,
- Statistikat e Hotelerisë,
- Statistikat e Transportit,
- Statistikat e Tregtisë me Pakicë,
- Statistikat e Industrisë,
- Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve,
- Indeksi i Inputeve dhe Outputeve në Bujqësi,
- Anketa e Fuqisë Punëtore,
- Mirëqenia Sociale,
- Buletini Tremujor.

## **3. Publikuar në baza mujore:**

- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HICP)
- Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Kosovës.

### **ASK gjithashtu mban regjistrat statistikorë, si më poshtë:**

1. Regjistri i Popullsisë,
2. Regjistri i Ekonomive Shtëpiake,
3. Regjistri i Shtëpive dhe Banesave,
4. Regjistri i Biznesit,
5. Regjistri i Qarqeve të Regjistrimit,
6. Regjistri i Ekonomive Bujqësore,
7. Regjistrat dhe bazat e të dhënave të tjera.
8. Regjistri i Vendbanimeve dhe Komunave në Republikën e Kosovës

## 4.5. Metodologjia

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) prodhon statistika bazuar në metodologjinë e zbatuar nga Eurostat-ti. Populacioni dhe përzgjedhja e mostrës bazohet më një seri procesesh statistikore, siç janë: dizajnimi-hartimi dhe përpilimi i mostrës për ekonomi familjare dhe biznese, mbledhjen e të dhënave, teknikat e vlerësimit, llogaritja e peshave, redaktimi dhe korigjimi i të dhënave, imputimi, kalibrimi dhe zvogëlimi i mos-përgjigjes.

Metodat e rekomanduara statistikore ndryshojnë me kalimin e kohës, falë hulumtimit-kërkimit dhe zhvillimit në këtë fushë. ASK po punon rregullisht për të rritur cilësinë e statistikave duke përmirësuar metodat statistikore.

Cilësia: Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe për të ruajtur besimin e publikut dhe zbatimin e programit të mbuluar nga statistikat zyrtare të Ligjit të Statistikave Nr.04/L-36, do të bazohet në parimet e mëposhtme: Relevanca, paanshmëria, objektiviteti, konfidencialiteti, efektiviteti i kostos, minimizimi i barrës për të anketuarit, pavarësinë profesionale, transparencën, konfidencialitetin statistikor, koordinimin dhe harmonizimin dhe përdorimin e të dhënave individuale vetëm për qëllime statistikore.

Metadata: Metadata referuese ose raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë e përdorura për mbledhjen dhe nxjerrjen-gjenerimin e të dhënave. Ato poashtu ofrojnë informacion mbi cilësinë e të dhënave. Në këtë mënyrë ato ndihmojnë përdoruesit që të interpretojnë saktë të dhënat.

Aktualisht, ASK përdor dy forma standarde për të dokumentuar metadata referuese: ESMS (Struktura e metodave Euro-SDMX) dhe ESQRS (Struktura e raportimit të cilësisë së ESS) të cilat janë standarde që përdoren në Sistemin Evropian të Statistikave.

Qëllimi i raporteve të formatit ESMS është të dokumentojë metodologjitë, aspektet e cilësisë dhe proceset e prodhimit statistikor në përgjithësi, ndërsa raportet e formatit ESQRS ofrojnë informacion për të vlerësuar cilësinë e të dhënave.

Linqet e mëposhtme përmbajnë kanale më të rëndësishme për më shumë informacion lidhur me përdorimin e metodologjisë:

- <https://ec.europa.eu/eurostat/data/metadata>
- <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/ask-metadata>

## 4.6. Shpërndarja / diseminimi i statistikave zyrtare

Shpërndarja e të dhënave statistikore paraqet fazën finale në procesin e prodhimit Statistikor dhe mënyrën e ofrimit të të dhënave zyrtare për të gjithë shfrytëzuesit e statistikave zyrtare. Aktivitetet e shpërndarjes i referohen të gjitha statistikave zyrtare dhe përfshijnë prezantimin e rezultateve zyrtare statistikore, si dhe bazën metodologjike dhe mjetet dhe metodat e sigurimit të qasjes në rezultate. Detyrimi për shpërndarjen e të dhënave statistikore buron në Ligjin për Statistikat Zyrtare. Shpërndarja e të dhënave zyrtare bëhet në të njëjtën kohë, në mënyrë objektive, pa anime për të gjithë shfrytëzuesit

**Strategjia e diseminimit** e ASK-së ka si **qëllim kryesor përdoruesin e kënaqur** dhe bazohet në praktikën evropiane të shpërndarjes. Strategjia bazohet në praktikën më të mirë evropiane të shpërndarjes dhe parimet e saj bazohen në Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane.

**Objektivat** kryesore të strategjisë së shpërndarjes janë:

1. ASK të jetë burimi i preferuar i të dhënave statistikore për Kosovën;
2. të sigurojë të dhëna statistikore për debate publike në Kosovë;
3. të përmirësojë ndërveprimin dhe dialogun me përdoruesit.

**Mjetet dhe kanalet** më të rëndësishme për shpërndarje janë:

- ASK Data, mjet online për shpërndarje ([askdata.rks-gov.net](http://askdata.rks-gov.net))
- Faqja e internetit e ASK-së <https://ask.rks-gov.net/>
- Faqet e mediave shoqërore, sic është Facebook (<https://www.facebook.com/Statistikat/>);
- Twitter ([https://twitter.com/ask\\_rks](https://twitter.com/ask_rks));
- Publikimet në format të PDF-së.
- Publikime të shtypura, të tilla si Vjetari Statistikor ose publikimet që kanë rëndësi të veçantë.

**Mediat e lajmeve** informohet në mënyrë aktive në lidhje me botimet e reja statistikore. ASK ndërmerr aktivitete për **prezantimin dhe shpjegimin e botimeve statistikore për shtypin dhe median e lajmeve**, dhe kur është e nevojshme, **mban konferenca për shtyp dhe takime me media**.

Duke marrë parasysh nevojat e grupeve të ndryshme të përdoruesve, ASK siguron informacione themelore, të standardizuara, por edhe informacione specifike për përdoruesit. Për të qenë në gjendje të kënaqë më mirë nevojat e përdoruesve, ASK mbledh informacion mbi nevojat dhe kompetencat e grupeve të ndryshme të përdoruesve, gjurmon përdorimin e platformave në internet dhe implementon **Anketën e Kënaqëshmërisë së Përdoruesit** në baza të rregullta.

Për më shumë informacion, ju lutemi konsultohuni me dokumentin e fundit të **Strategjisë së Shpërndarjes së ASK-së**.



#### 4.7. Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi dhe raportimi për vendosjen e proceseve statistikore është një nga proceset e rëndësishme të menaxhimit në ASK. **Sistemi i Brendshëm i Raportimit të Kohës (SIPK)** është mjeti kryesor për monitorim. Bazuar në këtë dhe njësi të tjera horizontale, ASK mund të sigurojë informacione mbi performancën-punën vjetore paraprake. Ky proces monitorimi kryhet përmes të ashtuquajturës **Kornizë e Vlerësimit të Performancës (KVP)**. Monitorimi dhe raportimi i performancës në nivelin e ASK-së dhe fushave statistikore përkatëse sektoriale bëhet çdo vit, ose në afate më të shkurtra kohore.

### 5. Struktura organizative e ASK-së

Aktivitetet e ASK-së janë të strukturuar në tetë departamente. Ato përfshijnë pesë departamente operacionale që kryejnë aktivitete statistikore të prodhimit dhe tre departamente mbështetëse që ofrojnë planifikim, koordinim, metodologji, IT, shpërndarje dhe komunikim, menaxhim të burimeve njerëzore, mbështetje administrative, ligjore dhe financiare për vendosjen e veprimtarive të prodhimit statistikor.

**Departamentet operative** janë:

1. Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit
2. Statistikat Ekonomike
3. Llogaritë Kombëtare dhe Ekonomia Informale
4. Statistikat Sociale, përfshirë Statistikat Demografike
5. Regjistrimit dhe Anketimit

**Departamentet mbështetëse** janë:

1. Teknologjia e Informacionit dhe Metodologjia
2. Departamenti i Politikave, Planifikimit, Komunikimit dhe Koordinimit
3. Mbështetje dhe Administrim

ASK menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv. Secili Departament menaxhohet nga Drejtori përkatës. Departamentet më të mëdha ndahen në divizione, secili divizion menaxhohet nga Shef i Divizionit.

Secili Departament i përfshirë në prodhimin statistikor është përgjegjës për

- zhvillimin, publikimin dhe zbatimin e planit të punës pesë-vjeçare që përditësohet çdo vit;
- të punuar drejt përdorimit të klasifikimeve, standardeve dhe metodologjive të Eurostat;
- sigurimin e krahasueshmërisë së të dhënave statistikore të Kosovës me të dhënat ndërkombëtare.

Struktura organizative e ASK-së rregullohet me **Rregulloren për Riorganizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës** duke paraqitur në detaje aktivitetet e secilit departament dhe sektorë të tij. Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni Rregullores në fuqi.

**Struktura organizative e ASK-së** paraqitet në **Shtojcën nr. 1**.

### 5.3. Statistikat Ekonomike

Statistikat e çmimeve - Ky modul përdoret për të zgjeruar të kuptuarit e pjesëmarrësve me konceptet dhe metodat e përpilimit të CPI, HICPs, WPIs, PPI, etj. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (ICK-CPI): është statistikë që përdoret për të matur çmimin mesatar të një shporte të zakonshme të përdorur për mallrat dhe shërbimet në një periudhë në raport me disa periudha bazë. Çmimi i periudhës bazë të shportës shënohet në 100 dhe vlera e CPI qëndron mbi ose nën 100 për të reflektuar nëse çmimi mesatar është rritur ose ulur gjatë periudhës. Pasi të kemi vlera të CPI-së për dy periudha, ne mund të përcaktojmë nivelin e inflacionit gjatë periudhave si diferenca midis dy vlerave të CPI-së, të ndarë me vlerën fillestare të CPI-së.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumatorit (IHÇK-HICP): është listë e kostove përfundimtare të paguara nga konsumatorët evropianë për artikujt në një shportë të mallrave të zakonshme. Është masë e përbërë e inflacionit në Eurozonë, prodhohet nga secili vend anëtar i Bashkimit Evropian (BE) për të matur inflacionin dhe për të udhëhequr Bankën Qendrore Evropiane (ECB) në formulimin e politikës monetare.

Indeksi i Çmimeve me Shumicë (ICSH-WPI). E dyta: ICSH-WPI, mat dhe ndjek ndryshimet në çmimin e mallrave në fazat para nivelit të shitjes me pakicë. Përderisa artikujt WPI ndryshojnë nga një vend në tjetrin, ato kryesisht përfshijnë artikujt në nivelin e prodhuesit ose shitjes me shumicë. Për shembull, përfshin çmimet e pambukut për pambuk të papërpunuar, fije pambuku, produkte gri pambuku dhe veshje pambuku.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimi (ICP-PPI) është tregues-indeks i lidhur i cili mat nivelin mesatar të çmimit të marrë nga shitësit. Lëvizja e tij parathotë ndryshimet e pritura në CPI, megjithë disa ndryshimeve që ekzistojnë në metodologjinë e tyre të llogaritjes. Kjo është familje e treguesve që matin ndryshimin mesatar në çmimet e shitjeve të marra nga prodhuesit vendas të mallrave dhe shërbimeve me kalimin e kohës. PPI mat ndryshimet e çmimeve nga këndvështrimi i shitësit dhe ndryshon nga CPI-ja i cili mat ndryshimet e çmimeve nga këndvështrimi i blerësit.

## 6. Dokumentet relevante

Për më shumë informacion mbi veprimtarinë e ASK-së mund të kontrolloni dokumentet e mëposhtme:

### Ligjet:

1. Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës
2. Ligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës
3. Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë
4. Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil
5. Rregullorja nr. 04/2015 për kodin e mirësjelljes ndaj shërbyesit civil

Për informacion shtesë, ju lutemi vizitoni: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/legjislacioni>

### Dokumente mbi veprimtarinë e KAS:

1. Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022
2. Programi Kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizimit dhe asociimit 2020-2024
3. Plani vjetor i Statistikave Zyrtare (plani i fundit në dispozicion tani ai për vitin 2020: "Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2020")
4. Raportet vjetore
5. Strategjia e diseminimit / shpërndatjes
6. Rregullorja për riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës
7. Deklarata e Cilësisë
8. Parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane

Për informacion shtesë, ju lutemi vizitoni linkun vijues: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/planet-dhe-raportet>

### Falenderim:

#### Aktiviteti 5.4. Themelimi i funksionimit të trajnimit të brendshëm

Ky dokument është përgaditur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës gjegjësisht Departamenti për Politika, Planifikim, koordinim dhe komunikim.

Dokumenti është ndihmuar dhe përkrahur nga znj Pataki Csilla, Ekspert i Menaxhimit dhe Zhvillimit Organizativ, në kaudër të projektit Kombëtar ( SIDA-BE) për fuqizim të Sistemit Statistikor të Kosovës.

## 7. Shtojca nr 1. Grafiku i organizimit të ASK-së

